



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:012075
Datë: 26.09.2024
Numri i dokumentit: 06211205

C-IV-14-7113

Parashtruesi i kërkesës

A Z, Ferizaj, përfaqësuar nga avokat **B I** Prishtinë.

kundër

Pala kundërshtare

Agjencioni Kosovar i Privatizimit- AKP (NSH “Tregtia” në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 26 shtator 2024 lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- Kërkesa për rishikimin e Aktvendimit të Autoritetit të Likuidimit aprovohet si e bazuar.**
- SHFUQIZOHET Aktvendimi e Autoritetit të likuidimit GJI097-0222 datë 15 tetor 2014.**
- Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankueses, A Z në emër të kompensimit të pagave të papaguara, ti paguhet shuma prej 3,960.00 Euro dhe në emër të interesit ligjor prej 8 % t'i paguhet shuma prej 316.80 Euro si dhe në emër të taksave gjyqësore shuma prej 20.00 Euro.**
- Obligohet Autoriteti i Likuidimit që përfaqësuesit të ankueses, avokat B I në emër të përpilimit të kërkesës për rishikim – ankesës si dhe përgjigjes ndaj përgjigjes së AKP të ja paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 208.00 Euro.**
- Nuk caktohen shpenzime tjera.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 21 nëntor 2014, pranë DHPGJS, ankuesja parashtror kërkesë, të emërtuar ankesë, për rishikimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) GJI097-0222 datë 15 tetor 2014, (në tekstin e mëtutjeshëm Vendimi), me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave të papaguara, për periudhën nga viti 2005 e gjer me 27 maj 2008, në shumë prej 3,960.00 (tre nëntë gjashtë zero) Euro, ndaj NSH “Tregtia” (në likuidim).

Ankuesja Vendimin e AL e kundërshtoj për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të dispozitave materiale.

Ankuesja pohoj, se AKP, i ka ndërprerë marrëdhënien e punës me 27 maj 2008, si pjesë e grupit të parë të punëtorëve të cilëve i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Ankuesja, tutje pohoj se ishte e përfshirë në listën e punëtorëve të cilët janë përfitues të pjesës nga 20% nga privatizimi i NSH.

Ankuesja e kundërshtoj arsyetimin e Vendimit të AL, në kuptim të vendimmarrjes nga ana e NSH, duke konsideruar se nuk mund të qëndron arsyetimi ku AL nuk e pranon legjitimitetin dhe kompetencat e Bordit drejtues të NSH, duke vazhduar se me Agjencia me po të njëjtin organ ka pasur komunikime të vazhdueshme dhe se po kjo Agjenci ka pranuar listën fillestare të punëtorëve të pranueshëm në listën e punëtorëve të cilët kanë gëzuar të drejtën në 20% nga privatizimi i NSH. Ky veprimi dhe arsyetimi i AL, sipas ankueses, bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të Rregullores së UNMIK-ut 2005/18.

Ankuesja në vijim, konsideron se Vendimi i AL bie në kundërshtim me dispozitat ligjore. Sipas ankueses, AL ka zbatuar gabimisht dispozitat ligjore të Ligjit për punën e bashkuar-LPB nga fakti se me hyrjen në fuqi të Ligjit mbi ndërmarrjet – LN (gazeta zyrtare 77/88 me plotësime dhe ndryshime) Ligji për punën e bashkuar është shfuqizuar dhe nuk mund të aplikohet. Po ashtu ankuesja pohon se Ligji mbi marrëdhëniet e punës së Kosovë (gazeta zyrtare e KSAK nr. 12) ndër tjerash nuk parashihet parashkrimin dhe se punëtori gëzon të drejtën e shpërblimit të ardhurave personale sipas akteve vetëqeverisëse. Përfundimisht ankuesja konsideron se Agjencia, në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, ka pranuar borxhin ndaj saj.

Nga të gjitha arsyet, si më lartë, ankuesja i propozoj gjykatës që kërkesën e saj mbi pagat ta aprovoj si dhe kërkoj kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.

Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur:

- Kopja e Autorizimit për përfaqësuesin,
- Kopja e Vendimit të AL,
- Kopjen e listë së punëtorëve, të NSH, përfitues të pjesës së 20% nga privatizimi i NSH, në të cilën shihet si e përfshirë edhe ankuesja (në tekstin në vijim LISTA E PUNËTORËVE),
- Kopja e vërtetimit lëshuar nga NSH, mbi marrëdhënien e punës së ankueses nga data 8 shtator 1987 e gjer me 27 maj 2008 (në tekstin në vijim VËRTETIMI),
- Kopja e Njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, datë 27 maj 2008, lëshuar nga Agjencia, drejtuar ankueses (në tekstin në vijim NJOFTIMI), dhe
- Një kopje e palexuar e librezës së punës.

Me 16 prill 2020, nga përfaqësuesi i ankueses u parashtrua një parashtrësë mbi plotësimin e padisë.

Ankuesja edhe me anë të kësaj parashtrësë mbeti në tërësi si pranë kërkesës për rishikim-ankesës. Ankuesja arsyeton kërkesën e saj mbi pagat, me listat e bashkangjitura mbi pagat. Edhe me këtë parashtrësë, sikurse edhe në kërkesën për rishikim – ankesë ankuesja i referohet dispozitave të njëjta ligjore, mbi parashkrimin e kërkesave dhe shton dispozitat ligjore të Ligjit për procedurën kontestimore, ato të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve si dhe Konventës Europiane mbi liritë dhe të drejtat e njeriut – KELDNJ. Ankuesja i referohet vendimeve të DHPGJS si dhe Vendimeve të Gjykatës Europiane mbi liritë dhe të drejtat e njeriut. Ankuesja përfundimisht

përveç shumës së kërkuar në lartësi prej 3,960.00 (tre nëntë gjashtë zero) Euro në emër të kamatë vonesave kërkoj shumën totale prej 554.40 (pesë pesë katër) Euro si dhe 8% bazuar në dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve.

Parashtresës mbi plotësimin, i janë bashkangjitur:

- Lista e punëtorëve të cilët kanë punuar gjer me 27 maj 2008, e të cilëve i është ndërprerë marrëdhënia e punës, si dhe të cilëve NSH u ka mbet borxh në paga, për vitet 2005, 2006, 2007 dhe 2008. Ankuesja, sipas listë, është e përfshirë në këtë listë sipas numrit rendor 8 (në tekstin në vijim LISTA E PAGAVE TË PUNËTORËVE 1), dhe
- Listën e pagave, të punëtorë të NSH, për muajin janar dhe dhjetor 2005 si dhe janar dhe dhjetor 2008. Ankuesja është e përfshirë në listë, sipas numrit rendor 13 respektivisht 14 (në tekstin në vijim LISTA E PAGAVE TË PUNËTORËVE 2), dhe
- Kopja e NJOFTIMIT.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 23 gusht 2024 parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. Sipas AKP AL me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e ankuesit ka vendosur në mënyrë të drejtë. AKP tutje pohon se ankuesja nuk ka ofruar argumente ligjore, në favor të ankesës së saj, ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP, si edhe në vendimin e AL, kundërshtoj legjitimitetin e Bordit të NSH si dhe informatave shtesë të pranuar nga po ky bord. AKP gjithashtu pohon se kërkesa kreditore e ankueses konsiderohet e parashkruar në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për punën e bashkuar-LPB respektivisht të pabazuara sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. Nga gjitha arsyet propozoj që kërkesa për rishikim të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Duke vepruar sipas urdhrin të gjykatës, ankuesja me 20 shtator 2024 parashtroj përgjigjen ndaj përgjigjes së AKP.

Edhe me anë të kësaj përgjigje, ankuesja mbeti në tërësi si pranë kërkesës për rishikim dhe parashtresës mbi plotësimin e kërkesës për rishikim ashtu që kundërshtoj pretendimet e AL lidhur me parashkrimin, tutje i referohet listës së pagave dhe përfundimisht kërkoj që kërkesa e saj të aprovet.

Përfaqësuesi i ankueses kërkoj kompensimin e shpenzimeve gjyqësore në shumë totale prej 208.00 dhe atë kërkesës për rishikim-ankesës, përgjigjes ndaj përgjigjes së AKP dhe 20.00 Euro në emër të taksave gjyqësore të paguara.

Arsyetimi ligjor

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet e bazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Lidhur me pagat e paguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 dhe 1.6.2 parashihet:

- a. përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar

në tri paga mujore bruto për person, si dhe

- b. e drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7, të shtojcës së Ligjit për AKP, parashihet përmbusha e kërkesave siç janë: “kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”.

Nga dispozitat e lartë cekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. Pagat e punonjësit, në këtë rast ankuesit, nuk janë paguar, duke u kufizuar në tri paga bruto por edhe përfshirë edhe kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë,
- b. Marrëdhënia e punës i është ndërprerë si rezultat i Vendimit të AKP, dhe
- c. Ndonjë veprimi tjetër nga ana e Agjencisë, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Në këtë rast ankuesja, në kuptim të nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS, ka arritur që të dëshmojë se ka qenë punëtore e NSH në kohën e privatizimit të saj dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit/veprimit të AKP.

LISTA E PUNËTORËVE, VËRTETIMI, NJOFTIMI LISTA E PAGAVE 1 dhe LISTA E PAGAVE 2, si dhe NJOFTIMI të parashtruara nga ankuesja, argumentojnë faktin se E njëjti ka qenë punëtore aktive e NSH-së gjër me datën e privatizimit.

LISTA E PAGAVE 1 dhe LISTA E PAGAVE 2, argumentojnë faktin se:

- a. ankueses i janë mbetur borxh pagat e papaguara.

AKP, asnjëherë, nuk i ka kundërshtuar shumat e kërkuar nga ana e ankueses, respektivisht nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka ankueses do ti mohojë e drejta në kompensimin. AKP faktet nuk i kontestuar (*positive litis contestation*) e për më tepër provat e parashtruara, siç u cekën më lart, kanë dëshmuar, vërtetësinë e pohimeve të palës së kundërt, në këtë rast ankueses. Kjo shihet nga fakti se AKP, edhe si një nga arsyet mbi refuzimin e kërkesës e potencon çështjen e parashkrimit. Arsyet e AL lidhur me legjitimitetin e Bordit të NSH, gjykata i konsideron si të pabazuara. Është e drejtë e punëtorëve, që sipas akteve të tyre vetëqeverisëse të NSH, që të zgjedhin formën e qeverisjes dhe përfaqësimit të tyre, qoftë nga ana e Këshillit të punëtorëve, Tubimit të punëtorëve apo edhe Bordit të saj.

Gjykata me rastin e aprovimit të shumës, është bazuar në LISTA E PAGAVE 1.

Nga LISTA E PAGAVE 1 shihet shuma e mbetur e papaguar.

Në rastin konkret me rastin e vendosjes, mbi shumën e kërkesës mbi pagat e papaguara, gjykata në kuptim të nenin 76.3 të Ligjit për DHPGJS lidhur me nenin 2.1 (*vendosja brenda kufijve të kërkesave*) të Ligjit për procedurën kontestimore –LPK, vendosi si në pikën 3 të dispozitiv të aktgjykimit.

Andaj nga të gjitha arsyet e dhëna si më lartë gjykata konsideron se ankuesja ka arritur që të dëshmoj të drejtën në kompensim, sipas nenit 40 paragrafi 1.6.1 dhe 1.7 të Shtojcës së Ligjit për AKP.

Nga gjitha arsyet u vendos si në pikën 3 të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me kamatën ligjore, sipas pikës 3 (tre) të dispozitivit, veproj në pajtim me nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit për AKP lidhur me nenin 2.1 të Ligjit për procedurën kontestimore- LPK (vendosja brenda kufijve të kërkesave).

Cështja e parashkrimit të kërkesave të ankueses

Ankuesja, ka pranuar njoftimin nga Agjencia, dhe me këtë njoftim është informuar si në vijim, citat:

- a. Si pasojë e shitjes së aseteve të NSH ky njoftim është njoftim zyrtar se punësimi juaj përfundon menjëherë (marrëdhënia e punës i ndërprerë me veprim të Agjencisë), dhe
- b. Shumat – pagat e papaguara që u janë borxh do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit (pranim i borgjit).

AL me anë të vendimit të saj si dhe AKP në përgjigje ndaj rastit të ngjashëm, lidhur me parashkrimin i referohet nenit 608 pika 1 të Ligjit për punën e bashkuar - LPB (gazeta zyrtare e RSFJ 53/76).

Këtë konkludim të AKP-së gjykata e konsideron si aplikim të gabuar të dispozitave ligjore, nga arsyet si në vijim.

Tutje lidhur me parashkrimin e kërkesave, sipas nenit 608 në paragrafin 2 të LPB thuhet:

“Në parashkrimin e kërkesave sipas pikes 1 të këtij neni në mënyrë të ngjashme aplikohen rregullat e përgjithshme mbi parashkrimin e kërkesave, në rastet kur ato kërkesa parashkruhen për tri vite”.

Së pari, duke u nisur mbi parimet e përgjithshme mbi parashkrimin të aplikuara dhe referuar sipas Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (gazeta zyrtare RSFJ nr. 29/78 me plotësime dhe ndryshime 39/85, 45/89, 31/93), dhe duke konsideruar se kërkesa është e natyrës kreditore, në nenin 366 paragrafi 1 thuhet, citat:

“Njohja me shkrim i detyrimit të parashkruar konsiderohet si heqje dorë nga parashkrimi”

Më tutje sipas nenit 370, të po të njëjtit ligj, thuhet:

“ Rregullat për parashkrimin nuk zbatohen në rastet kur me ligj janë caktuar afatet brenda të cilave duhet të paraqitet padia ose të kryhet një veprim, nën kërcënim të humbjes së të drejtave”.

Dispozitat e lartëcekura të LMD, ishin në aplikim në kohën e marrjes së njoftimit.

Dispozita identike parashihen edhe sipas Ligjit të Kosovës (nr. 04/L-077) për marrëdhëniet e detyrimeve (neni 347 dhe 351), dispozita ligjore këto, në aplikim në kohën e marrjes së Vendimit të AKP.

Sipas dispozitave të lartë cekura AKP me vet faktin e njoftimit me shkrim ndaj ankueses për obligime nga marrëdhënia e punës konsiderohet se ka hequr dorë nga parashkrimi.

Tutje, rregullat për parashkrimin nuk mund të zbatohen sepse veprimi i vetëm i ankuesit, në rastin konkret, ishte kërkesa drejtuar pranë Komitetit të Likuidimit e që afatet dhe procedura e likuidimit rregullohet me ligj të veçantë e në këtë rast me Ligjin për AKP (shtojca e ligjit) dhe se përfundimisht afatet rrjedhin nga momenti i njoftimit së procedurës së likuidimit.

Së dyti, duke u bazuar në nenin 370 të LMD Jugosllav respektivisht nenit 351 të LMD të Kosovës, Ligji për AKP – shtojca e saj, rregullon procedurën e likuidimit të një NSH si procedurën dhe mënyrën e likuidimit si dhe përmbushjen e obligimeve ndaj kreditorëve eventual, afatet e parashtrimit të kërkesave etj.

Si ilustrim, të lartë cekurës, shih nenin 10 të Shtojcës së Ligjit për AKP ku parashihet se çdo procedurë eventuale, gjyqësore, administrative etj, ndaj një NSH e cila tani më ka hyrë në proces të Likuidimit, duhet të ndërpritet.

Përfundimisht procedura e likuidimit të një NSH, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, është e vetmja mënyrë proceduralo - ligjore lidhur me përmbushjen e obligimeve kreditore, si ndaj punëtorëve e po ashtu edhe ndaj kreditorëve tjerë potencial (lex specialis).

Asnjë punëtor apo kreditor potencial, nuk mund ti realizoj të drejtat e tyre kreditore ndaj një NSH, pa hapjen e procedurës së likuidimit nga ana e AKP, dhe referenca si ajo se parashtruesi nuk ka inicuar rast ligjor, konsiderohet i papranueshëm.

Në bazë të nenit 54 paragrafi 1 nenit 74 paragrafi 4 të Ligjit për DHPGJS u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesja ka paguar taksat gjyqësore.

Bazuar në nenin 6.2 lidhur me numrin tarifor 6.1 dhe 6.2 të Rregullores për tarifën e avokatëve, datë 18 mars 2017, vendosi si në pikën 4 (katër) të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar